



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË  
29.12.2023

Me datë 29.12.2023, u mbajt mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Oltion Luli, Jona Leqeza, Edmond Ndou, Uarda Gjekaj, Hilmi Lakti, Blediane Nika, Fatbardh Dama, Vjollca Petani, Erald Erkoçaj, Armela Brahimi, Mirsad Bashi, Hedije Nasa, Ardit Taflaj, Alma Mehmetaj, Gezim Galiqi, Erlinda Kavaja, Taulant Shahmani, Jurgena Bracaj, Florian Bjanku, Joniz Osmanagaj, Irena Shala, Irma Kopliku, Gjenarin Kapcari, Valjeta Bajraktari, Ardit Behri, Eliona Shkreli, Aleksander Pashuku, Gjergj Sokoli, Rezarte Pode, Lulash Nika, Ervin Brahim, Violeta Perndrecaj, Gjovalin Ndoj, Ardit Spahija, Samed Bushati, Suada Kopshti, Erkan Hoxha, Marina Duhani, Blendi Gjylbegaj, Gloria Shllaku, Imeldi Sokoli, Muharrem Shkjau, Amina Lici, Plarent Anamali.

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit Z.Oltion Luli  
Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/ Vendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Nëntor 2023".
2. Pr/ Vendim: "Për miratimin e nivelit të bursave për nxënësit e viteve të para, të dyta e lart të shkollave të mesme për vitin 2023-2024"
3. Pr/ Vendim: "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKB nr.1 date 22.01.2016 për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Shkodër", të ndryshuar.
4. Pr/ Vendim: "Për një ndryshim në VKB nr.71, datë 27.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të bashkisë së Shkodrës", të ndryshuar: dhe "Për një ndryshim dhe shtesë në VKB nr.12 datë 20.07.2023 "Miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë"
5. Pr/ Vendim: "Për miratimin e buxhetit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër".
6. Pr/ Vendim: "Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit vjetor 2025"

Kourumi i domosdoshëm është i pranishëm në sallë, mbledhja deklarohet e hapur. Para se rendi i ditës të hidhet në votim, fjalën e merr Z. Bjanku dhe shprehet se bëhet fjalë për paketën fiskale dhe buxhetin, të dyja këto shumë të rëndësishme dhe me impakt të jashtëzakonshëm tek qytetarët e Shkodrës, por kjo është në shkelje të procedurës ligjore dhe rregullores funksionale të këshillit, përkatësisht ligji për financat e vetqeverisjes vendore nr.68/2017, neni 39 dhe 41, të cilët përcaktojnë qartë datën 30 nëntor si afat maksimal, kur Pr/buxheti duhet t'i paraqitet Këshillit bashkiak. Gjithashtu edhe rregullorja e Këshillit përcakton në nenin 42 pika 3 se njoftimi për mbledhje dhe materialet për pr/buxhetin duhen bërë minimalisht 10 ditë pune para. Për më tepër ky pr/buxhet nuk është diskutuar në komisionet e përherëshme të këtij këshilli, të paktën tek ai i buxhetit dhe i çështjeve ligjore për shkak të mosmarrjes pjesë së anëtarëve. Po ashtu edhe paketa fiskale, shton Bjanku nuk është diskutuar në dëgjesë publike. Dëgjesa e mbajtur me datë 27 është kryer vetëm me pjesëmarrje të anëtarëve të këshillit dhe administratës së bashkisë dhe jo nga grupet e interesit, që preken direkt. Nuk ka pasur as prezencë të mediave. Në këto kushte ai kërkon heqjen e këtyre dy pikave nga rendi i ditës (pr/buxhetin dhe paketën fiskale).

Z.Luli sqaron në lidhje me procedurën duke cituar kodin e procedurës administrative ligji nr.44 pika 4, i cili thotë se dita e shtunë dhe e dielë apo festat zyrtare nuk pengojnë fillimin apo kohëzgjatjen e afateve. Përsa i përket komisioneve, ato kanë zhvilluar mbledhjet konform rregulloreve dhe secili nga këshilltarët kanë marr pjesë me vullnetin e tyre të plotë, kurse administrata e bashkisë ka qenë në nivelin e duhur të pjesëmarrjes si në prezantimin e fishave buxhetore po ashtu edhe për sugjerime apo ndryshime të nevojshme të rekomanduara. Hidhet në votim rendi i ditës, ku rezultojnë 25 vota Pro, 13Kundër, 0 Abstenim.

#### **Miratohet**

Kalohet në pikën e pare të rendit të ditës: Pr/ Vendim: “*Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Nëntor 2023*”.

Relaton Znj.Kruja, drejtore në drejtorinë e Shërbimeve sociale në Bashkinë e Shkodrës sipas materialit të përgatitur nga administrata. Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë 39 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

#### **Miratohet**

Vijohet me pikën 2. Pr/ Vendim: “*Për miratimin e nivelit të bursave për nxënësit e viteve të para, të dyta e lart të shkollave të mesme për vitin 2023-2024*”

Relaton Z. Gjozef Kulla, drejtor në drejtorinë ekonomike të arsimit në Bashkinë e Shkodrës sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Fjalën e merr Znj.Nika , e cila në cilësinë e kryetares së komisionit shprehet pro Pr/aktit.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë 40 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

#### **Miratohet**

Vijohet me pikën 3.të rendit të ditës: “*Për disa ndryshime dhe shtesa në VKB nr.1 date 22.01.2016 për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Shkodër*”, të ndryshuar.

**Relaton Z. Bekim Mema**, specialist në drejtorinë e planifikimit strategjik dhe klimës së bisnesit sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Fjalën e merr **Z.Gjylbegaj**, i cili shprehet se në lidhje me taksat dhe tarifat vendore konstatohet një rritje të taksës së ndikimit në infrastrukturë, që në mendimin e tyre është e pa studuar dhe për më tepër nuk shihet se ka ndikim në buxhet. Për më tepër nuk është llogaritur impakti që do ketë kjo rritje takes. Kjo do të ndikojë negativisht tek xhepat e qytetarëve së pari, tek çmimet e banesave si dhe tek punësimi si dhe mendojmë që do sjelli edhe stopim të ndërtimeve dhe shtim të atyre pa leje. Ne propozojmë që kjo taksë të rrijë ashtu siç është, në minimumin e parashikuar.

**Z.Dibra**, drejtor në drejtorinë e Planifikimit urban saron së pari se cilat taksa do pësojnë rritje. Ai thekson se rritja prej 4% në 8% vlen vetëm përobjektet e destinuara sektorit të turizmit, industrisë etj, kurse objektet për shërbime publike, banimi etj janë 3% e preventivit të vlerës së ndërtimit. Pra, rritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë është rritur vetëm për ato objekte, të cilat produktin final kanë shitjen. Po ashtu kemi edhe ulje të taksës nga 3% në 1% të asaj të bujqësisë. Ai mendon se nuk mund të quhet rritje takes por indeksim duke parë rritjen e çmimeve në përgjithësi. Ne vijmë me një propozim të tillë shton ai duke bërë një analizë të detajuar të ndërtimeve dhe duke ditur që kjo taksë konvertohet nga ana e bashkisë në infrastrukturë publike. Kjo po ashtu është një polikë shfrenuese ose orientuese e ndërtimit që Bashkia Shkodër ka për 4 zona specifike të qytetit.

**Z.Imeldi Sokoli** merr fjalën dhe shprehet në lidhje me atë çka tha Z.Dibra, duke thënë se kjo është një polikë orientuese por që njëkohësisht do rrisë edhe ndërtimet pa leje. Bashkia është institucion publik garantues dhe jo orientues i tregut të ndërtimeve. Kurse në lidhje me taksen e shfrytëzimit të tregut, ai kërkon të dijë nëse kryet ndonjë anketë të qytetarëve, për të testuar mundësinë/përballimin e pagesës së këtyre tarifave të reja? Nëse po, si është kryer ky anketim?

Përgjigjet **Z.Mema** duke thënë se tarifa që është paguar deri tanë nga tregtarët është e pamjaftueshme si për të mirëmbajtur ambientet e tregut, si dhe për të nxjerrë në vazhdim investimet që po planifikojmë për të bërë në këto struktura.

Përsëri **Z.Sokoli** shton se vërehet se pavarësisht rritjeve të tarifave nuk shkon në mënyrë direktë të përmirësimimi shërbimit në tregje apo përmirësimit të jetës në përgjithësi për qytetarët sepse investimet në 2023 ishin 16.8% dhe sot me buxhetin e ri shkojnë 13.5%. Pra kjo rritje taksash nuk pasqyrohet në investime.

**Z.Anamali** ka një pyetje për Kryetarin **Z.Beci**, ai shprehet se me anë të një shkresë ka kërkuar t'i vihen në dispozicionë gjithë studimet e kryera në lidhje me ndryshimet dhe rritjen e këtyre taksave. Ai shprehet se akoma nuk ka një përgjigje për informacionin e kërkuar.

**Znj.Shestani** po ashtu kërkon informacion ose të dhëna mbi studimet apo analizat e kryera për këto tarifa të reja. Ajo pyet: 1. Se në ç'bazë janë vendosur këto tarifa? 2. Po taksa e tregjeve a do jetë e përballueshme për tregtarët duke ditur edhe rënien e konsumit si defekt ky

i emigracionit. Indirekt kjo do përkthehet në rritje çmimesh dhe pse jo edhe në faliment të këtyre tregtarëve. 3. Si do të nxisë shoqëria “Bio Strajca” prodhimin e produkteve lokale, dhe a do t’i vijë në ndihmë këtyre tregtarëve apo do t’i falementojë?

**Z.Dibra** përgjigjet se ne jemi të gatshëm t’ju vëmë në dispozicion çdo të dhënë të studimit të kryer nga ana jonë edhe pse ai thotë se më sipër përmendi një analizë të shkurtër të asaj ç’ka ka sjellë taksat e reja.

**Z.Mema**, në lidhje me tarifat e reja të propozuara për shfrytëzimin e hapësirave publike në tregje, të cilat njëkohësisht do administrohen nga Bio Strajca, kemi të bëjmë në këtë rast siç u tha më lart me rritje taksash që do shërbejnë për mbulim më të mirë të shërbimeve dhe rritje investimesh në këtë sektor. Shoqëria Bio Strajca do ketë funksion administrimin dhe menaxhimin e këtyre tregjeve publike për të rritur eficencën, efektivitetin ~~dhe cilësinë~~ në tregtimin e produkteve.

**Z.Bjanku** në lidhje me taksën në infrastrukturë, kërkon të dijë se si do procédohet me kërkesat ekzistuese të ardhura në Bashki, të cilat akoma nuk kaën marr leje. Duke u nisur edhe nga parimi i sigurisë ligjore si do bëhet llogaritja, me taksat e reja? Apo është menduar që ato të mbesin me taksat e vjetra?

Përgjigjet **Z.Dibra** duke thënë se kjo normalisht do shihet në mënyrën që përcakton ligji.

Fjalën e merr **Znj.Shkrela**, e cila shprehet dakort me sa u tha më sipër në lidhje me taksën në infrastrukturë duke theksuar edhe njëherë që kjo sigurisht që do rrissi pasigurinë e ndërtuesve dhe ndikon direkt në xhepat e qytetarëve. Po ashtu edhe rritja e taksës për tregtarët çon në rritje të çmimeve dhe kosto e shtuar për qytetarët.

Ajo kërkon të dijë edhe në ç’bazë është kryer faturimi i subjektit politik PD për mbledhjen e mbajtur në ambjentet e kinema “Millenium”, pasi ajo vëren mospërputhje tarifash mes subjekteve politike. A mund të kemi transparencë të faturave të kryera nga PS për mbledhjen e mbajtur në teatrin Migjeni?

Ndërhyn **Z.Luli** duke thënë se këto janë pyetje jashtë rendit të ditës.

Po ashtu edhe **Z.Beci** përgjigjet se merrni informacion nëse kërkesa juaj vjen në rrugë zyrtare me anë të një shkrese, pasi nuk dëshirojmë që këtë mbledhje ta kthejmë në debate çështjesh politike.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë 30 vota Pro, 13 Kundër, 0 Abstenim.

#### Miratohet

Vijohet me pikën 4.të rendit të ditës: Pr/ Vendim: “Për një ndryshim në VKB nr.71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të bashkisë së Shkodrës”, të ndryshuar: dhe “Për një ndryshim dhe shtesë në VKB nr.12 datë.20.07.2023 “Miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësise”

Relaton **Znj. Ardita Peraj**, drejtore në drejtorinë e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Shkodër sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Fjalën e merr **Znj.Shestani**, e cila shprehet se duke ditur qe kjo ndërmarrje përfshin edhe objektet kulturore, arsimore të qytetit, kërkjmë nga ana juaj të na sqarohet fakti se si do kryhet procedura e mbylljes së këtyre institucioneve: teatrit, degës ek.të kulturës etj? Po trupa e aktorëve të teatrit si do quhet tani ose stafi i bibliotekës? Po numri që zbat ose diferenca e punonjësve që do kalojnë në këtë drejtori të re, si do do bëhet procedura e mbylljes së vendit të punës ose largimit të tyre?

Përgjigjet **Znj.Peraj** duke thënë se me miratimin e këtij pr/vendimi do dali një strukturë e re dhe pozicionet në fjalë dojenë të përqëndruara në Bashkinë qendër.

Ndërhyr **Z.Beci** dhe sqaron se ndërmarrjet/institucionet si Biblioteka, Teatri, Qendra Kulturore P.Gaci etj kanë funksionuar në koncept si qendra shpenzuese. Ato kishin një strukturë të plotë, financier, rojë, hidraulik etj. E thënë ndryshe ishin struktura paralele të cilat në mirëmbajtje krijonin problem dublimi punësh. Kjo besoj është një mënyrë për të bërë punë optimale në të njëjtin drejtim. Asnjë nga këto institucione nuk do të lëvizë, thjesht mirëmbajtja e tyre do bëhet nga disa punëtorë të specializuar. Kriteri bazë i përzgjedhjes do jetë sigurisht aftësia, profesionalizmi, përkushtimi dhe përgjësia.

Përsëri **Z.Anamali** shprehet se në relacionin e paraqitur thuhet se është kryer një analizë e detajuar e shkrirjes së këtyre drejtorive varësie. Pse nuk na është vënë në dispozicion kjo analizë? Po ashtu ju shpreheni se kjo shkrirje ka avantazhe, a e dispononi ju një studim të tillë ku dalin si rezultat këto avantazhe?

**Znj.Peraj** përgjigjet se kjo analizë iu është vënë në dispozicion këshilltarëve me anë të një e-maili si përgjigje kërkesës së Z.Bjanku.

**Z.Sokoli** shprehet se tek shifrat e paraqitura të buxhetit , kjo teza e rritjes së eficencës që u përmend bie poshtë pasi paga e sigurime shoqërore, pësojnë rritje në 2024.

Përgjigjet **Znj.Haxhi**, duke sqaruar se rritja e shifrave është pasojë e rritjes së pagës minimale dhe pagave në vazhdim.

**Z.Gjylbegaj** thotë se ideja e një ndërmarrjeje të tillë duket e pëlqyeshme dhe parimisht e mirë por do kishim dashur të jemi më të qartë se si do procedohet me drejtoritë që do pësojnë ndryshim nga ana funksionale. Për më tepër në relacion thuhet se organika dhe struktura e kësaj drejtorie do caktohet nga Kryetari i bashkisë, kur një kohë është Këshilli bashkiak, organi që miraton strukturën dhe organikat e tjera, pse në këtë rast kemi devijim?

Përgjigjet përsëri **Znj.Peraj** e cila sqaron se struktura siç u tha do dal pas miratimit të këtij pr/vendimi nga Këshilli.

Edhe **Z.Beci** shton se strukturat mbeten të pandryshuara, vetëm pjesa e mirëmbajtjes kalon tek ndërmarrja e re.

Edhe **Znj.Leqejza**, drejtore juridike në Bashkinë Shkodër sqaron se nëpunësit që janë më kod pune, specialistë etj do mbisin në Bashkinë Shkodër qendër. Këshilli bashkiak miraton vetëm numrin dhe buxhetin për këta punonjës. Vetëm punonjësit e mirëmbajtjes do kalojnë në ndërmarrjen e re.

**Znj.Shestani** kërkon të dijë konkretisht sa persona largohen me krijimin e kësaj ndërmarrje?

**Znj.Peraj** shprehet se këtë do ta përcaktojë komisioni i posaçëm që do ngrihet për këtë qëllim.

Edhe **Z.Pashuku** shprehet se edhe tek Bordi i kullimit dhe tek dr.e pyjeve dhe kullotave vëren ulje të numrit të punonjësve.

**Znj.Peraj** thotë se edhe këta punonjës do kalojnë në organikën e ndërmarrjes së re.

**Znj.Shestani** në emër të grupit politik BF kërkon sipas rregullores 15 minuta pushim për konsultim.

---

Kalohet në mendimet e kryetarëve të grupeve, **Z.Ndou** shprehet pro pr/vendimit, po ashtu edhe **Z.Sokoli**. **Znj.Shala** në emër të kuolicionit BF shprehen kundër miratimit të pr/aktit, po ashtu edhe **Znj.Shllaku** për grupin PD shprehet kundër.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë 31 vota Pro, 12 Kundër, 0 Abstenim.

#### **Miratohet**

Vijohet me pikën 5.të rendit të ditës: Pr/ Vendim: “Për miratimin e buxhetit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër”.

Relaton për këtë pr/akt **Z.Beci** duke theksuar vizionin dhe priorititetet e këtij Buxheti dhe plani buxhetor.

Për detaje më specifike fjalën e merr **Znj.Haxhi**, drejtore në drejtorinë e Buxhetit, e cila sqaron në mënyrë të detauar materialin e përgatitur.

Relacion nga ana e komisionit të buxhetit nuk ka, pasi nuk ka patur kourum, prandaj kalohet në pyetje nga këshilltarët.

**Z.Bjanku** thotë se sqarimi i materialit ishte shumë teknik dhe për transparencë për qytetarët dëshirojmë të dijmë sa rrugë do bëhen, sa parqe fëmijësh, sa qendra shëndetësore etj? Pra konkretisht, përveç shifrave çfarë do bëhet për Shkodrën në 2024?

Edhe **Z.Anamali** kërkon të dijë sa janë pasqyruar në këtë pr/buxhet kërkësat dhe sugjerimet e qytetaëve të dala nga dëgjesat publike? Së dyti ai vëren që ka një rritje të të ardhurave nga tarifa e pastrimit prandaj dëshiron të dijë mbi ç'bazë është bërë kjo rritje dhe sa % të të ardhurave mbulan Bashkia me tarifimin e familjeve, bisneseve dhe institucioneve?

**Znj. Golemi** shprehet se kryetari Beci tha se peshë të madhe do kenë investimet, kur në materialin e paraqitur vërejmë se investimet zënë vetëm 14% të buxhetit. Pra shihet një ulje e konsiderueshme e investimeve. Cila është arsyja e kësaj tendencë parashikuese në rënien të ardhurash për periudhën afatmesme? Po ashtu edhe parashikimet për turizmin janë shumë të pakta. A nuk është pak kondadiktore kjo politikë që po ndiqet kur shprehemi se kemi rritje të turizmit.

**Z.Galiqi** merr fjalën dhe shprehet se duke parë investimet që priten në vitet 2024-2026 mos ndoshta ka ardhur koha për të riparë edhe njëherë planin e zhvillimit të qytetit mbi bazën e strategjive dhe projekteve të reja, duke ditur edhe impaktin që kanë tëk qytetarët?

**Znj.Shestani** shprehet se në materialin e paraqitur flitet për ndërhyrje, ndërtim dhe rehabilitimitë qendrave shëndetësore në një kohë që janë parashikuar vetëm 2 milion lekë për të gjitha këto në 2024. A mund ta dimë ku do ndërhyhet konkretisht? Po ashtu dëshiron ajo dëshiron të dijë se si do procédohet me qendrën shëndetësore tek Adisa, ku do sistemohen? Po qendra multifunksionale që është inaguruar në Rajonin nr.1, kur do fillojë funksionimin?

**Znj.Shllaku** shprehet se vëren në relacion parashikohen disa ndërhyrje në institucionet arsimore por nuk cilësohen se ku konkretisht do kryhen këto ndërhyrje?

**Znj.Kopliku** merr fjalën dhe kërkon të dijë pse planifikimi për arsimin e mesëm të përgjithshëm është në ulje? Po ashtu tek transparenca, ajo ndalet tek pastrimi. Bashkia Shkodër ka marr me dt.24.10.2023 njoftim për rritje tarife të depozitimit në landfillin e Bushatit për mbetjet urbane. Pjetja është sa është efekti i kësaj rritjeje në buxhet dhe me çfarë fondesh do mbulohet?

**Z.Osmanagaj** vëren që rrëth 40% e buxhetit shkon për rritjen e pagave në vitin 2024, kurse në 2025 shohim një ulje të këtij fondi. A mund të kemi një sqarim për këtë? A do ketë ulje të punonjësve dhe cilat janë kriteret që do kërkohen në administratë? Apo do ketë përsëri ulje pagash?

**Znj.Shkrela** shprehet se u fol për projekte strategjike, kur qytetarët e Shkodrës kanë që në 2019 që dëgjojnë për rrugën e Zogajve por asgjë e bërë konkretisht. A është e sigurtë që ndërhyrja do fillojë në 2024? Po ashtu flitet për ndërtimin e një muzeu navigimi, në një kohë që ura e Bunës që nga ndërtimi i saj është hapur me mekanizëm vetëm një herë. A mendoni se nëse flasim për lumin Buna të lundrueshëm, ky mekanizëm a funksionon akoma? Gjithashtu edhe në lidhje me projektin 4D të paraqitur në fushatë nga Z.Beci, a janë takuar banorët që do preken nga prishjet nga projektit në fjalë? Ajo shton se edhe tek kultura ndarja e buxhetit nuk duket e drejtë. Nuk është e drejtë sipas saj që i është dhënë rëndësi disa aktiviteteve më shumë se disa të tjerave të cilat tashmë janë vlera për qytetin e Shkodrës siç është p.sh Festivali i Jazz-it. Po ashtu për sa i përket rrjetit rrugor, janë disa rrugë të cilat kanë ardhur me kërkesë të banorëve për ndërhyrje, vërej qe nuk janë parashikuar në këtë buxhet. Gjithashtu për transparencë kërkojmë të dimë meqënëse tender nuk ka, ku janë marrë paratë për gjithë zbulimet dhe pagesat e këngëtarëve që kanë përfomuar përfundit?

**Znj.Petani** shprehet se këtu nuk kemi ardhur të diskutojmë politikisht por të miratojmë buxhetin dhe paketën fiskale për më të mirën e qytetit.

**Znj.Mehmetaj** në cilësinë e kryetares së komisionit të buxhetit shprehet se ky buxhet që pret të miratohet ka një vizion krejt ndryshe që e sheh Shkodrën si një qendër rajonale dhe kombëtare, element ky që i ka munguar Shkodrën në vite. Ajo prezanton shkurtimisht një material të përgatitur për buxhetin. Ajo thekson faktin se në këtë buxhet janë përfshirë edhe ankesat dhe prioritetet e qytetarëve, të dala nga dëgjesat publike. Është menduar që të ketë gjithëpërfshirje.

**Znj.Duhani** merr fjalën dhe dëshiron të sqarojë Znj.Shkrela në lidhje me rrugën Bardhaj, rrugë e cila është filluar nga Qarku Shkodër dhe është rënë dakort që të përfundohet po nga

Qarku. Në cilësinë e kryetarit të Qarkut e ka miratuar në buxhet dhe shumë shpejt do përfundojë.

**Z.Behri** kërkon të dijë se sa ka qënë buxheti për turizmin në 2023 meqë kemi një “bum” turistik. Po ashtu pse është hequr data e hapjes së sezonit turistik? Dhe tregu që parashikohet të hapet në Velipojë, ku do bëhet meqënëse ka ndikim edhe në turizmin e zonës?

**Z.Luli** sqaron se pyetjet e bëra janë ezauruar në mbledhjet e komisioneve.

**Z.I.Sokoli** në lidhje me rrugët rurale thotë se vërehet se ka një rënie në investimet e tyre, aq më tepër që disa janë me bashkëfinancim. Kemi vetëm 6 projekte në këtë fishë/projekt kur në 2023 kemi pasur 34 projekte. Pse ka ndodhur kjo? Së dyti, përsa përket programit të ~~transportit publik dhe lëvizshimit, në fishe projekt nuk dëtajohet asgjë, thuhet vetëm që ka vijezime rrugësh, blerje tabelash, sinjalistikë etj. A mos është më e drejtë që ky investim prej 50 milion lekësh të reja, të shkojnë direkt për investim dhe përmirësim të infrastrukturës duke rritur kështu edhe numrin e projekteve? Dhe në lidhje me programin e menaxhimit të mbetjeve, një pjesë të madhe zë në buxhet edhe pagesa për landfillin e Bushatit. Ne kemi kohë që kemi propozuar uljen e sasisë së mbetjeve me anë të pikave të kompostimit apo pikave stacionare të mbetjeve. Nuk është marr parasysh kjo gjë. Vërehet ulje e numrit të kazanëve dhe frekuencës së pastrimit, një kohë që na trumpetohet që kemi përmirsim të situatës në menaxhimin e mbetjeve. Pse ndodh kjo?~~

**Z.Beci** sqaron edhe njëherë se investimet në rrjetin rrugor nuk do jenë më të copëzuara por do bëhen investime të plota e me standarte. Një pjesë e rrugëve do bëhen me kosto operacionale dhe jo me kontraktorë direkt. Ndërmarrja që do krijojmë do prodhojë shumë më tepër infrastrukturë, rregullime nëpër fshatra apo qytet. Koncepti i këtij buxheti do jetë ndryshe. Kemi eleminuar kështu punën me kontrata duke ngritur struktura të tjera më eficiente.

**Zn.Jona Leqeja** shprehet se ndryshimet në buxhet nuk janë sasiore por me minuse në njérën anë e me pluse në anë të tjera. Kjo ndodh edhe nga krijimi i tre njësive shpenzuese. Ajo përgëzon paralelisht vizionin e kryetarit të bashkisë dhe ekzekutivit të tij përsa i përket investimeve publike.

**Z.Bjanku** për procedurë kërkon që pyetjet e drejtuara duhet të marrin përgjigje pastaj të kalohet në diskutime.

**Z.Pashuku** merr fjalën dhe thotë që parashikohet investim në Nj.Adm.Bërdicë, konkretisht tek harku i Bërdicës, por ky investim parashikon edhe ndërtimin e trotuareve. Së dyti në 2023 në Nj.Adm.Bërdicë janë kryer dy rrugë dhe fondi për to është paraqitur në 2024, a mund të përdoret për dy rrugë të tjera në zonë? Edhe përsa i përket shpronësimeve nga harku i Bërdicës deri në hyrje të qytetit të Shkodrës, a do merret parasysh vlera reale e tregut për ato banorë që disponojnë dokumentet përkatës.

**Znj.Shestani** shprehet se duke qënë se mbledhjet e komisioneve nuk kanë pasur kourum, atëherë sipas rregullores janë null. Ky projekt buxhet është dashur të shihet dhe të studiohet më shumë nga ana jonë dhe jo të kalohet në një afat kaq të shkurtër.

**Znj.Haxhi** sqaron se lidhur me përshkrimin e fishave të pr/buxhetit baza ligjore mbetet e njëjtë, prandaj është e njëjtë përshkrim kurse në lidhje me rrugët, janë të gjitha të listuara në fisha. Gjithashtu ajo përgjigjet në mënyrë të detajuar pyetjeve të drejtuara duke cituar pr/buxhetin.

**Edhe Znj.Xhakoni** merr fjalën dhe përgjigjet në lidhje me pyetjet mbi menaxhimin e mbetjeve duke thënë se kostoja e shërbimit të menaxhimit është e detajuar në fishë pr/buxhetit. Kosto kjo që mbulohet rrëth 70% nga tarifa e pastrimit dhe pjesa tjetër nga transferta specifike për mbetjet urbane e akorduar nga qeveria. Sa për transparencë, komunikimi që kemi marr nga landfilli i Bushatit për rritjen e tarifës ka një efekt financiar prej 11% në fishë. Kosto kjo që do mbulohet po ashtu nga buxheti i bashkisë.

Në lidhje me pyetjet për infrastrukturën përgjigjet **Z.Kuqi** i cili flet në mënyrë të detajuar për rëndësinë e ndërhyrjeve të parashikuara dhe priorititet që priten të realizohen në 2024, të gjitha këto të paraqitura në këtë pr/buxhet.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Z.Ndou shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD Z.Sokoli po ashtu shprehet dakort miratimit të Pr.vendimit, kurse Znj.Shala për grupin BF dhe Z.Gjylbegaj për grupin PD nuk janë dakort.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë 31 vota Pro, 12 Kundër, 0 Abstenim.

#### Miratohet

**Z.Shkjau** merr fjalën dhe përgëzon punën e bërë , shprehet po ashtu se ai do votojë gjithmonë pro për projekte në të mirë të qytetit dhe qytetarëve të Shkodrës.

Kalohet në pikën 6. të rendit të ditës: Pr/ Vendim: “*Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit vjetor 2025*”

Relaton për këtë pr/akt **Znj.Haxhi**, drejtore në drejtorinë e Buxhetit, e cila sqaron në mënyrë të detajuar materialin e përgatitur.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë 33 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

#### Miratohet

Në përfundim **Z.Beci** falenderon të gjithë sfafin për punën e kryer dhe këshilltarët për të gjithë mbështetjen, motivimin dhe sugjerimet e dhëna.

Pyetje e diskutime të tjera nuk ka. Kryetari e Këshillit e deklaron mbledhjen të mbyllur.

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përbledhur diskutimet e mbledhjes së këshillit bashkiak Shkodër të datës 29.12.2023. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban **10** faqe dhe pasi lexohet, nënshkruehet pa vërejtje nga:

Zbardh procesverbalin  
Irma Sulishti

---

Sekretar

Denis LESHË

